



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN  
NGA DISKRIMINIMI**

**KRYEMINISTRIA  
AGJENCIA E OFRIMIT TË  
SHËRBIMEVE PUBLIKE TË  
INTEGRUARA (ADISA)**

Nr. 1655 prot.  
Tiranë, më 30.10.2019

Nr. 1283 prot.  
Tiranë, më 30.10.2019

### **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

#### **NDËRMJET:**

**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi** - (në vijim KMD), me seli në adresën: “Ruga e Durrësit” (ish Ministria e Mjedisit), Tiranë, është një person juridik publik, që është ngritur dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. Nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përfaqësuar nga Komisioneri **Z. Robert GAJDA**,

*DHE*

**Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara** - (në vijim ADISA), me seli në adresën: Bulevardi “Zhan D’Ark”, i cili është një person juridik publik, që është ngritur dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 13/2016, datë 18.02.2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv **Z. Lorin YMERI**.

Palët, bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (këtu e më poshtë referuar si “Marrëveshja”), si më poshtë vijon:

#### **Neni 1**

#### **Objekti i Marrëveshjes**

- 1.1 Në Marrëveshje midis tyre, palët bien dakord që brenda ambienteve të *Zyrave Rajonale/Vendore të ADISA-s* (në vijim *Qendrat e Integruara*), Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi do t’i vihet në dispozicion poste pune të dedikuara për ofrimin e shërbimeve në bazë të ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
- 1.2 Ambientet e Zyrave Rajonale/Vendore dhe numri i posteve të punës, të cilat do të vendosen në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, do të përcaktohen nga ADISA, mbi bazën e kërkesës së KMD, si dhe në varësi të fluksit të



kërkesave të qytetarëve për shërbimet e KMD-së dhe hapësirës fizike të Zyrave Rajonale/Vendore.

## **Neni 2** **Baza Ligjore**

- 2.1 Për lidhjen dhe zbatimin e kësaj marrëveshje, palët i referohen dhe mbështeten mbi bazën ligjore si më poshtë:
- Neni 119 dhe 121 i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;
  - Nenet 901 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;
  - Ligji Nr. 13/2016, datë 18.02.2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”;
  - Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

## **Neni 3** **Afati i Marrëveshjes**

- 3.1 Afati i kësaj Marrëveshje është 2 (dy) vjet, me të drejtë rinovimi dhe fillon nga data e nënshkrimit të saj nga palët.
- 3.2 Marrëveshja rinovohet automatikisht për një periudhë kohe të pacaktuar, nëse asnjëra nga palët nuk njofton me shkrim palën tjetër për përfundimin e saj, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para përfundimit të afatit të përcaktuar, sipas pikës 3.1 të këtij neni.

## **Neni 4** **Të drejtat dhe detyrimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi**

- 4.1 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi merr përsipër:
- 4.1.1 Të ofrojë shërbimet e saj në sportelet e Zyrave Rajonale/Vendore të vendosura në dispozicion nga ADISA pa kundërshpërblim.
  - 4.1.2 Të pajisë sportelet e saj me të gjitha pajisjeve të nevojshme TIK (kompjuter, printer, skaner, fotokopje etj.), duke siguruar kushte normale pune;
  - 4.1.3 Bën të mundur funksionimin e sistemit të KMD (nëse ekziston një i tillë), të nevojshëm për ofrimin e shërbimeve të saj në sportelet e Qendrave të ADISA-s
  - 4.1.4 Të vendos në dispozicion punonjësit e ngarkuar prej saj për ofrimin e shërbimeve në sportel, të cilët duhet të respektojnë tërësinë e rregullave për etikën e sjelljes, komunikimit dhe veshjes, sipas standardeve të ofrimit të shërbimeve në sportel.
  - 4.1.5 Të pranojë ankesat e qytetarëve në lidhje me cilësinë e ofrimit të shërbimit ndaj qytetarëve të mbledhura nga punonjësit e ADISA-s, pranë Qendrave të Integruara të cilat i përcillen me shkrim në fund të çdo dite. KMD shqyrton ankesat brenda afateve ligjore dhe në varësi të shkeljes merr masat e nevojshme ndaj punonjësve përkatës.



- 4.1.6 Të ushtrojë të gjitha detyrat të ngarkuara sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, dhe kuadrin ligjor në fuqi që rregullon veprimtarinë e saj në hapësirën e caktuar, ashtu si janë ushtruar edhe përpara nënshkrimit të kësaj marrëveshje.
- 4.1.7 Të mirëmbajë të gjitha mobilet, pajisjet dhe mjetet e tjera të dhëna në përdorim nga ADISA gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes dhe i dorëzojë ato në gjendje pune në momentin e përfundimit të Marrëveshjes, duke marrë në konsideratë amortizimin normal të tyre.
- 4.1.8 Të sigurojë bazën materiale të domosdoshme për funksionimin e sporteleve të saj dhe ofrimin e shërbimeve.
- 4.2 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka të drejtë të përdor sportelet e vendosura në dispozicion nga ADISA pranë Zyrave Rajonale/Vendore, për ofrimin e shërbimeve të saj.
- 4.3 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka të drejtë të përdor Sistemin e Menaxhimit të Radhës (Queue Management), të vendosur në ambientet e Zyrave Rajonale/vendore, për ofrimin e shërbimeve të saj.

## Neni 5

### Të drejtat dhe detyrimet e ADISA

#### 5.1 ADISA merr përsipër:

- 5.1.1 Të vendosë në dispozicion pa kundërshtim, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi poste pune, në ambientet e Zyrave Rajonale/Vendore, të mobiluara (*post pune i kompletuar me tavolinë, karrige, raft*), duke siguruar kushte normale pune dhe akses nga publiku;
- 5.1.2 Të trajtojë punonjësit e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi që do të shërbejnë në sportel, lidhur me etikën e komunikimit, modelet e sjelljes, menaxhimit të presionit në punë etj., me qëllim përgatitjen e tij për të ofruar shërbimin në mënyrë sa më të shpejtë dhe cilësore për qytetarin;
- 5.1.3 Të sigurojë sistemin e menaxhimit të radhës, edhe për sportelet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në mënyrë elektronike dhe të përbashkët me sportelet e tjerat të Qendrës së Integruar;
- 5.1.4 Të ofrojë informacion për qytetarët nëpërmjet sportelit të informacionit (info-point) lidhur me shërbimet e ofruara nga sporteli i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- 5.1.5 Të mbledh dhe administrojë ankesat e qytetarëve në lidhje me cilësinë e ofrimit të shërbimit nga punonjësit e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që shërben në sportel dhe ia përcjellë me shkrim këtij të fundit.
- 5.1.6 Të kërkojë zëvendësimin e punonjësit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nëse ky i fundit nuk respekton standardet e ofrimit të shërbimeve në sportel, duke cënuar



rendë imazhin e ADISA-s. Me kërkesën e ADISA-s, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zëvendëson punonjës in menjëherë.

- 5.1.7 Të marrë në dorëzim në përfundim të Marrëveshjes ambientet e dhëna në përdorim, mobiliet dhe pajisjet në gjendjen që i ka dorëzuar, duke konsideruar amortizimin normal të tyre.
- 5.2 ADISA ka të drejtë të kërkojë nga punonjësit e KMD, të cilët ofrojnë shërbim, zbatimin e standardeve dhe rregullave të ofrimit të shërbimeve publike në sportel.

#### **Neni 6**

#### **Punonjësit e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi**

- 6.1 Punonjësit, të cilët ofrojnë shërbimet e Komisionerit, pranë ambienteve të Zyrave Rajonale/Vendore të ADISA-s, është punonjës i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i emëruar në bazë të legjislacionit në fuqi dhe përcaktimeve të kontratës individuale të punës.
- 6.2 Marrëdhënia e tij e punës mbetet në fuqi dhe nuk transferohet te ADISA gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshje.
- 6.3 ADISA nuk ka detyrime financiare ndaj punonjësit të KMD-së, i cili shërben në sportelet e vendosura në hapësirat e Zyrave Rajonale/Vendore.
- 6.4 Punonjësit e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi kanë detyrimin të marrin pjesë në trajnimet që organizohen nga ADISA në kuadër të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve publike në sportel.
- 6.5 Punonjësit e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, respektojnë tërësinë e rregullave për etikën e sjelljes, komunikimit dhe veshjes, sipas standardeve të ofrimit të shërbimeve në sportel.

#### **Neni 7**

#### **Shpenzimet për funksionimin e sporteleve**

- 7.1 Shpenzimet për funksionimin e sporteleve përballohen nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe mbulojnë shpenzimet për pagat, sigurime shoqërore dhe shëndetësore për punonjës in e sportelit, si dhe shpenzimet operative (bojë për pajisjet, letër, kancelari etj.) për mirëfunksionimin e sportelit të shërbimit.
- 7.2 ADISA merr përsipër të sigurojë vendosjen në dispozicion të postit të punës brenda ambienteve të Zyrave Rajonale/Vendore, si dhe furnizimin e ambienteve të punës me linjë interneti, energji elektrike dhe ujë të pijshëm.
- 7.3 Pajisjet që jepen në përdorim gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes mbeten në pronësi të ADISA, e cila merr përsipër edhe amortizimin normal të tyre.

#### **Neni 8**

#### **Orari i funksionimit të sportelit**



- 8.1 Orari i pranimit të aplikimeve për sportelin është:  
E hënë - E premte ora 08:00 - 15:00
- 8.2 Orari gjatë të cilit ambientet e ADISA-s mund të përdoren nga punonjësi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi sipas kësaj Marrëveshje është 08:00-16:30 çdo ditë pune.
- 8.3 Përgjegjësit e sporteve të Zyrave Rajonale/Vendore do të raportojnë për paraqitjen e punonjësit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi çdo ditë zyrës së burimeve njerëzore të këtij të fundit.

### **Neni 9**

#### **Shkëmbimi i informacionit dhe i dokumentacionit**

- 9.1 Procesi i ofrimit të shërbimit në sportel do të bëhet në bazë të rregullimeve ligjore/nënligjore/kontraktuale në fuqi për ofrimin e shërbimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ligjit nr. 13/2016, datë 18.02.2016 “Për ofrimin e shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, për aq sa ky i fundit nuk bie në kundërshtim me rregullimet ligjore aktuale për ofrimin e këtyre shërbimeve.
- 9.2 Me kërkesë të ADISA-s, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i vë në dispozicion kësaj të fundit raporte në lidhje me aplikimet dhe afatet e përgjigjeve për aq sa është e mundur nga legjislacioni në fuqi.
- 9.3 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendos në dispozicion të punonjësit të sportelit të informacionit (info-point) të ADISA pranë Zyrave Rajonale/Vendore, materiale informuese të saj, si broshura dhe informacione të tjera në lidhje me shërbimet përkatëse.

### **Neni 10**

#### **Zgjidhja e Marrëveshjes**

- 10.1 Marrëveshja përfundon me përbushjen e afatit të përcaktuar në nenin 3 të saj.
- 10.2 Marrëveshja mund të zgjidhet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në rast se nuk janë plotësuar kushtet e nevojshme për ofrimin e shërbimit nga ADISA, si:
  - Vënia në dispozicion e postit të punës;
  - Vënia në dispozicion e mobilieve;
  - Furnizimi me internet.
- 10.3 Marrëveshja mund të zgjidhet nga ADISA në rast se:
  - Punonjësi i KMD nuk respekton në mënyrë të përsëritur tërësinë e rregullave për etikën e sjelljes, komunikimit dhe veshjes, sipas standardeve të ofrimit të shërbimeve në sportel;
  - KMD nuk siguron bazën materiale dhe pajisjet tik të nevojshme për funksionimin e sporteve dhe ofrimin e shërbimit.
  - KMD nuk respekton detyrimet e tjera të parashikuara sipas Nenit 4.
  - Për shkaqe të tjera objektive në interes publik.

10.4 Marrëveshja mund të zgjidhet përpara përmbushjes së afatit për shkaqe të arsyeshme me kërkesë të njërës palë, duke e njoftuar palën tjetër me shkrim, të paktën një muaj përpara.

**Neni 11**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

11.1 Çdo mosmarrëveshje që lind ose mund të lindë nga ose gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve, në rast të kundërt mosmarrëveshja zgjidhet sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

**Neni 12**  
**Hyrja në fuqi**

12.1 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.

**Neni 13**  
**Dispozita të fundit**

13.1 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u hartua në 2 (dy) kopje me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe.

**PALËT**

**PËR**

**KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN  
NGA DISKRIMINIMI**

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**



**PËR**

**AGJENCINË E OFRIMIT TË  
SHËRBIMEVE PUBLIKE TË  
INTEGRUARA (ADISA)**

**DREJTOR EKZEKUTIV**

**Lorin YMËRI**

